



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 1263 prot.

Vlorë, më 31.01 2023

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, Datë _____, 2023

“PËR EMËRTIM RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË VLORE”

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, neni 9/1 , pika 1.1/b pika 2, 9, neni 54 pika II, neni 55 pika 2 , kërkesën e Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë , Dega Vlorë me nr . 3885, datë 12.04.2022 si dhe në relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë në mbledhjen e datës _____,

VENDOSI:

1. Të miratojë emërtimin e rrugës pranë Akademisë me emrin “Azis Hasa ”sipas planimetrisë bashkëlidhur .
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”.

Konceptoi: S.Haxhiraj



KRYETARI

Dritan Leli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA V Lorë
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 1263 prot.

Vlorë, më 31.01 2023

RELACION

MBI PROJEKT VENDIMIN “PËR EMËRTIM RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË V Lorë”

PARA KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar Këshilltarë!

Ky projektvendim është hartuar bazuar në kërkesën e Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë , Dega Vlorë me nr . 3885, datë 12.04.2022 dhe gjen bazë në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 8 pika 2, 9, neni 54 pika II, neni 55 pika 2 .

Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë , Dega Vlorë vlerëson maksimalisht Z.Azis Hasa si figurë të rëndësishme të Luftës Antifashiste Nacional Clirimtare ,me një kontribut të vecantë si ushtarak në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë , si një partizan trim si dhe një kapiten i rangut të dytë të forcave detare dhe komandat i Akademisë së Detarisë.

Azis Hasa lindi në 12 prill 1925 në fshatin Kercukje të Tiranës .

Pasi diplomohet me rezultate të larta në Akademinë Ushtarake Detare në Azerbaxhan , BAKU bëhet pjesë e forcave detare të Republikës së Shqipërisë .

Deri në vitin 1952 ndoqi studimet në fushën e detarisë në Akademinë e Detarisë së nivelit më të lartë ushtarak në Voroshilov .

Nga viti 1952 deri sa doli në pension ka punuar si drejtues i trangjeve më të larta në forcat e Detarisë së Republikës së Shqipërisë .

Një nga detyrat ku kërkohej akademizimi i tij ushtarak ishte ajo e Komandantit të Akademisë së Detarisë Vlorë .

Përkushtimi i Komandant Azis Hasa si dhe i trupës së pedagogëve të asaj kohe coi në krijimin e një shkollë me nivelet më të larta të kohës dhe me konkurrencë dinjitoze me simotrat e saj në lindje dhe perëndim , duke e bërë këtë shkollë nga më të preferuarat në vend dhe më të njohurat në rajon dhe Europë për nivelin e lartë të studentëve të saj .

Breza të tërë e kanë gdhendur figuren e Komandant Azis Hasa si një komandant dinjitoz , plot kulturë , i cili rrezatonte mirësi dhe integritet të plotë edhe në kushte shumë të vështira. Komandant Azis Hasa ka mbajtur një qëndrim aktiv si antifashist në Luftën Nacional Clirimtare , duke spikatur me punën e tij të palodhur si drejtues i niveleve më të larta të FLD si dhe në vlerat e larta të drejtimit të Akademisë së Detarisë Vlorë

Nga sa më lart është në vlerësimin tuaj të miratoni emërtimin e kësaj rruge “ Azis Hasa ” si nder dhe vlerësim për këtë figurë të rëndësishme të Akademisë së Detarisë Vlorë .

Konceptoi: S. Haxhiraj

KRYETARI

Dritan Leli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E URBANISTIKES

Nr. 1263 prot.

Vlorë, më 31 04 2023

Lënda : Relacion Sgarues

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Vlorë.

Të nderuar,

Në lidhje me projekt vendimin “Për Emërtim Rrugë në Territorin e Bashkisë Vlorë”, ju bëjmë me dije se:



Porjektvendimi për emërtimin e rrugës “Azis Hasa”, është hartuar bazuar në kërkesën me Nr. prot. 3885, datë 12.04.2022 të Shoqatës Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë, dega Vlorë.

Nisur nga situata aktuale e rrugës lidhëse pranë zonës së Akademisë së Marinës, drejtorja e Urbanistikës po ju vendos në dispozicion segmentin rrugor të propozuar për vendosjen e këtij emërtimi.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!

Konc. Darjan Hudhra

DREJTOR
Zambak Selmani



[Handwritten signature]

BASHKIA VLORE

DREJTORIA E
URBANISTIKES

Dr. Zambak Selmani

Darjan Hudhira

[Handwritten signature]

— Filimi dhe mbarimi i Rruges "Azis Hasa"

VLORE 2023